

**VENDIM**  
**Nr. 192, datë 20.11.2020**

**MBI MBYLLJEN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN VENDIMIT TË BORDIT TË  
ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË SEKA  
HYDROPOWER SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC-et ‘SEKË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 *kw* DHE  
‘ZAIS’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 *kw*, ME KAPACITET TOTAL TË  
INSTALUAR 14962 *kw*”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 15 dhe 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 122/4 prot., datë 17.11.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, mbi kërkesën për rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 10.9.2020, vendosi: të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Sekë”; me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 28-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1140 prot., datë 1.10.2020, është paraqitur nga përfaqësuesja me prokurë të posaçme znj. D. N., kërkesa e komunitetit të zonës ku po zhvillohet projekti i HEC-ve “Sekë” dhe “Zais”, për rishikimin e këtij vendimi, duke pretenduar sa më poshtë:

1. Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. nuk ka të drejtë ligjore të aplikojë për licencë për HEC-in “Zais”, pasi referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe ekstraktit historik të shoqërisë, rezulton se objekti i kësaj shoqërie nuk përputhet me kërkesat e ERE-s për licencim.

2. Me VKM-në nr. 661, datë 31.10.2018, “Për zgjerimin e sipërfaqes së PK ‘Lurë’ dhe krijimin e PK ‘Lurë-Mali i Dejës’”, është vendosur bashkimi i dy parqeve kombëtare dhe krijimi i një parku të vetëm “Lurë-Mali i Dejës”. Si rezultat i kësaj VKM-je, tashmë, projekti i realizimit të dy HEC-ve shtrihet 2.08 km brenda këtij parku kombëtar, duke e bërë të paligjshme çdo veprimtari që zhvillohet në këtë park.

3. Me shkresën nr. 1044/1 prot., datë 6.9.2019, e AKZM-së, bën me dije se: “Rezulton se, rreth 2.08 km gjatësi të kanalit të derivacionit dhe vepra e marrjes së ujit për HEC-in, ndodhet brenda zonës së mbrojtur të PK “Lurë-Mali i Dejës”. Gjithashtu, edhe nga raporti i grupit ndërinstitucional të punës, të krijuar si rezultat i ankesave të banorëve, pranohet se, projekti zhvillohet pjesërisht në zonë të mbrojtur.

4. Nëpërmjet komunikimit elektronik të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), i është kërkuar shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., që të rinegociohet kontrata, pikërisht se zbatimi i projektit shtrihet në zonë të mbrojtur. Bashkëlidhur kërkesës për rishikim, është depozituar në cilësinë e provës e-mail-i i koordinatorit për të drejtën e informimit në MIE, të datës 24.6.2020.

- Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, rrethanave e fakteve të paraqitura në të, me e-mail-in e datës 22.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 1134 prot., datë 22.10.2020, përfaqësuesi i shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., ka kërkuar që të njihet me këtë kërkesë për rishikimin e vendimit nr.

146/2020, me qëllim që të mundësohet dhe dërgimi i informacionit të nevojshëm nga ana e shoqërisë.

- Në përgjigje, me shkresën nr. 1134/3, datë 30.10.2020, ERE i ka dërguar shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. dokumentacionin shoqërues mbi të cilin kërkuesi ka mbështetur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 146/2020, për t’u njohur dhe i ka kërkuar që të depozitojë në ERE çdo informacion apo dokumentacion që shoqëria beson se mund të argumentojë një qëndrim të kësaj shoqërie në lidhje me kërkesën për rishikim.

- Me qëllim marrjen e informacionit sa më sipër dhe në zbatim të nenit 92, të Kodit të procedurave administrative, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 168, datë 2.11.2020, vendosi: zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020.

- Pas marrjes së këtij vendimi, me shkresën nr. 25 prot., datë 2.11.2020, protokolluar në ERE me nr. 1134/3 prot., datë 3.11.2020, i licencuari ka depozituar në ERE argumentet dhe dokumentacion shoqërues në lidhje me sa pretenduar në kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 146/2020, duke argumentuar sa më poshtë:

1. Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. është shoqëria konçesionare e krijuar nga koncesionari, në përputhje me nenin 8.1, të kontratës së konçesionit. Kjo shoqëri ushtron veprimtarinë e përcaktuar në kontratën e konçesionit, duke mos ushtruar asnjë lloj veprimtarie tjetër tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuadër të kësaj kontrate.

2. Me VKM-në nr. 661, datë 31.8.2018, “Për zgjerimin e sipërfaqes së PK, Lurë”, është bërë zgjerimi dhe është krijuar territori PK “Lurë-Mali i Dejës”, zgjerim ky i bërë pasi projekti konçesionar është pajisur me lejen e ndërtimit nga KKT-ja, të miratuar më 3.10.2018. Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, nr. 1044/1 prot., datë 6.9.2019, rezulton se projekti konçesionar, me një gjatësi rreth 11 km (mendohet, por e pakonfirmuar akoma), rreth 2.08 km gjatësi e kanalit të derivacionit dhe veprës së marrjes të ujit në HEC-in Zais ndodhet brenda zonës së mbrojtur PK “Lurë-Mali i Dejës”.

3. I licencuari, sqaron se, kjo situatë është krijuar pas zgjerimit të parkut, pasi bazuar në shkresën nr. 1245/3 prot., datë 23.1.2018, të AZKM-së, konfirmohet se projekti konçesionar për ndërtimin e HEC-eve, “Seka” dhe “Zais” është jashtë zonave të mbrojtura.

4. Në nenin 73, pika 1, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, përcaktohet si vijon: personat fizikë e juridikë, që kanë fituar të drejta të ushtrojnë veprimtari të caktuara në zonat e mbrojtura, duke lidhur marrëveshje, kontrata apo janë pajisur me leje mjedisi për to, do të vazhdojnë t’i kryejnë normalisht veprimtaritë, përderisa ato nuk ndalohen shprehimisht nga ky ligj apo nuk vijnë haptas në kundërshtim me të.

5. VKM-ja nr. 661, datë 31.10.2018, njeh dhe merr në konsideratë praninë e projekteve të miratuara brenda kësaj zone të mbrojtur. Neni 4, i VKM-së nr. 661, përcakton shprehimisht: aktivitetet shfrytëzuese të burimeve natyrore, të cilat ndodhen brenda territorit të parkut kombëtar dhe që janë pajisur me leje mjedisore dhe/ose vendim të KKT-së deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të lejohet të vazhdojnë ushtrimin e aktivitetit nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”.

6. I licencuari argumenton se, projekti konçesionar i është nënshtruar të gjitha akteve paraprake për zhvillimin e këtij projekti, si VNM-ja e thelluar, deklaratë mjedisore, raport hidrologjik, raport hidrogeologjik, oponenca e raportit hidrologjik, leje për përdorimin e burimit ujor, lejen e ndërtimit etj., të cilat janë të vlefshme dhe nga të cilat provohet se nuk mund të vijë ndonjë ndikim negativ në burimet e ujit të pijshëm apo të ujit që përdoret për vaditje.

7. Shoqëria argumenton se është vetë AZKM-ja, e cila me anë të shkresës nr. 687/1 prot., datë 8.7.2020, ka informuar shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., se në bazë të studimit që është duke u

bërë për ndryshimin e kufijve të zonës së mbrojtur, zona në fjalë, që përfshin Melth dhe Zall-Gjocaj, është e parashikuar të jetë jashtë zonës së mbrojtur.

- Në përfundim, shoqëria ka bërë me dije ERE-n në lidhje me çështjet gjyqësore që shoqëria Seka Hydropower” sh.p.k., ka me ankuesit në gjykatën administrative të apelit, si vijon:

- Çështja me nr. 31132-04392-86-2019, datë regjistrimi 23.12.2019, me objekt: konstatimi i pavlefshmërisë absolute i kontratës publike konçesionare e formës “BOT”, me METE, lidhur më 12.6.2013, nr. 7030, me objekt ndërtimin e hidrocentraleve “Sekë” dhe kontratën shtesë, lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), më datë 18.8.2018 (nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013), me objekt “Ndërtimin e HEC-eve ‘Seka’ dhe ‘Zais’ në pellgun ujëmbledhës të lumit Urakë dhe Zallit të Melthit në Bashkinë Mat, qarku Dibër dhe në Bashkinë Mirditë, qarku Lezhë”, etj. 2. Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar punimet që kryhen në bazë të kontratës publike.

- Çështja me nr. 31157-02279-86-2020, datë regjistrimi 15.9.2020, me objekt: konstatimi i pavlefshmërisë absolute të deklaratës së mjedisit, me nr. identifikimi 533, nr. vendimi 33, 6220 prot., datë 19.7.2018. 2. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 25, datë 7.2.2019, të ministrit të Turizmit. 3. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit nr. 559/2 prot., datë 19.3.2019, i KKT-së. 4. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të shkresës nr. 1245/3 prot., datë 23.1.2018, të AZKM-së, për miratimin e zhvillimit të projektit. 5. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të lejes për përdorimin e burimit ujor nr. 179 prot., datë 17.9.2018, miratuar me vendimin e Këshillit të basenit ujor Mat, nr. 24, datë 12.9.2018. 6. Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur pezullimin e punimeve për realizimin e projektit “Ndërtimi i HEC-it ‘Sekë’ dhe ‘Zais’, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit”.

#### QËNDRIMI I ERE-s:

- Në kontratën shtesë të konçesionit, me nr. 2247 rep., nr. 1095 kol., datë 18.8.2017, është përcaktuar se me optimizimin e skemës së shfrytëzimit hidroenergjetik të veprës, hidrocentrali “Sekë” i parashikuar në kontratën konçesionare të lidhur më 12.6.2013, do të quhet në këtë kontratë me emrat hidrocentrali “Sekë” dhe “Zais”, duke përcaktuar më pas dhe karakteristikat për të dyja hidrocentralet.

- Ky dokumentacion është depozituar në ERE nga shoqëria që në fazën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, ka qenë i vlefshëm dhe vazhdon të mbetet i tillë sa kohë nuk është ndryshuar nga organi përgjegjës, autoriteti kontraktor apo me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente.

- Në nenin 4, të VKM-së nr. 661/2018, përcaktohet se mund të vazhdojë ushtrimi i atyre aktiviteteve që ndodhen brenda territorit të parkut kombëtar në rast se është pajisur me leje mjedisore dhe/ose vendim të KKT-së deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., ka depozituar në ERE deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 6220 prot., datë 19.7.2018, me nr. 533 identifikim dhe nr. 33 vendimi, për personin juridik “Seka Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtim i HEC-eve ‘Sekë’ dhe ‘Zais’”. Siç konstatohet, edhe kjo deklaratë mjedisore është lëshuar përpara daljes së VKM-së nr. 661, datë 31.10.2018.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., ka depozituar në ERE lejen e ndërtimit nr. 599/2 prot., datë 19.3.2019, lëshuar nga KKT-ja, me objekt “Ndërtimin e HEC-it ‘Sekë’ dhe ‘Zais’, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, qarku Dibër dhe në Bashkinë Mirditë, qarku Lezhë sipas vendimit nr. 16, datë 3.10.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit, leje e

cila është miratuar, siç citohet në objektin e saj, në vijim të vendimit nr. 16, datë 3.10.2018, të KKT-së, i miratuar përpara daljes së VKM-së nr. 661, datë 31.10.2018.

- Objekti i veprimtarisë së të licencuarit përputhet me kërkesat e ligjit dhe rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE konstaton se kërkuessit nuk kanë dhënë prova dokumentare e as arsyetimin e nevojshëm ligjor për të provuar se ushtrimi i aktivitetit nga i licencuari bie ndesh me parashikimet e VKM-së.

- ERE konstaton se ftesa në rrugë elektronike për diskutim/negocim nga autoriteti kontraktor (MIE) nuk përbën akt ligjor për ndryshimin e kontratës së konçesionit. Kërkuessi nuk provoi as ndryshimin e rrethanave të kontratës së konçesionit e as ndryshimin e statusit ligjor të kontratës së konçesionit mbi të cilën është mbështetur vendimmarrja e ERE-s.

- ERE konstaton se, pikërisht fakti që kërkuessi ka goditur për legjitimitet (pavlefshmëri absolute) aktet mbi të cilat është mbështetur kryesisht vendimmarrja e ERE-s nr. 146/2020, provon edhe një herë se kërkuessi ia ka deleguar gjykatës të drejtën për të përcaktuar legjitimitetin e tyre dhe se është në kushtet e pamundësisë për ta provuar kryesisht sa pretenduar në këtë kërkesë për rishikim.

- Sa më sipër rezulton se kërkuessi nuk ka provuar e as ka argumentuar në lidhje me prova të reja që lidhen me ndryshimin e statusit të dokumenteve mbi të cilat është mbështetur vendimi i ERE-s për licencimin e shoqërisë dhe as ka provuar që organet kompetente apo një vendim i formës së prerë i gjykatës të ketë miratuar apo ndryshuar përcaktimet.

- Asnjë nga provat e paraqitura nga kërkuessit në kërkesën e tyre për rishikim nuk ka faktuar paligjshmërinë apo pavlefshmërinë e dokumenteve mbi të cilat është bazuar vendimi i Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, e po ashtu asnjë prej këtyre pretendimeve nuk përbën një provë të re, të tillë që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai 146/2020.

- Në nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet: ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vet, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës konçesionare ose me kërkesën e të licencuarit. ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij.

- Në mbështetje të sa më sipër, ERE ka të drejtë në çdo kohë që rrethanat e mësipërme konstatohen të modifikojë kushtet e licencës apo ta shfuqizojë atë nëse plotësohen kushtet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”, si të pambështetura në prova.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**